



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

JANAR, 2024

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujoy bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujoye 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin janar 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH). Të dhënat e pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat e raportuara në SISI krahasohen nga DEKSI, dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit janar 2024 zënë 18.8 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 172.9/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 2.6/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën

laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin janar 2024 në nivel kombëtar.


Tabela 1: Frekuencat dhe incidentat e sëmundjeve diarreike për muajin janar 2024
(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste janar 2024	Incidenca janar 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	13	0.45
Shigelozë (Disenteri bacilare)	11	0.4
Dizenteri amebike	0	0.0
Toksiko-infeksione alimentare	74	2.6
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	4851	169.5
Sëmundje diarreike në total	4949	172.9

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina
2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit janar 2024 janë raportuar në total 171 raste variçelë (incidenca 5.97/ 100.000 banorë) nga të cilat, 59 raste janë të dyshuara dhe 112 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen varicelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 96 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 87 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, janar 2024




2.2 Fruthi

Gjatë muajit janar janë raportuar 70 raste si të dyshuar me fruth nga të cilat janë konfirmuar 18 (26%) raste nga ana laboratorike (15) dhe epidemiologjike (3). Incidenca e sëmundjes për muajin janar është 0.6 raste/100 000 banorë.

Grafiku2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth, janar 2024




Grafiku 3. Raste të konfirmuar me Fruth sipas datës së diagnozës dhe klasifikimit të rastit sipas transmetimit



Vërehet nga grafiku 3 se:

- 9 raste janë raste të lidhura kontakte familjare me njëri-tjetrin,
- 4 raste janë kontakte spitalore,
- 4 raste janë pa lidhje epidemiologjike me rastet e mësipërme.


Grafiku 4. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas datës së shtrimit/vizitës te mjeku



Vërehet se nga 18 rastet e konfirmuara vetëm 1(5.5%) rast është ndjekur në kushte shtëpie.

Rastet e tjera kanë qenë të shtruar pranë spitalit pediatrik QSUT dhe spitalit rajonal Durrës.

Grafiku 5. Shpërndarja e rasteve të konfirmuar sipas grup-moshës (%)



Përqindjen më të lartë e kanë grup-moshat 5-9 vjeç dhe 10-14 vjeç me 39 % secila.


Tabela 2. Rastet e konfirmuara sipas bashkive

Bashkia	Raste	%/totalit
Krujë	1	5.6
Tiranë	8	44.4
Durrës	9	50.0

Rastet i përkasin më tepër bashkisë Tiranë me 50 % të totalit.

Nga 18 raste, 14 raste janë të pavaksinuar (77.8%), 2 raste të vaksinuar me një dozë vaksine (11.1%), 2 raste me dy doza vaksine (11.1%).

Grafiku 6. Statusi i vaksinimit në rastet e konfirmuara




Vaksinimi i rasteve është verifikuar në të dhënat e kartelave të vaksinimit (SIV).

3. Hepatitet virale

Hepatiti viral B (HBV)

Në muajin janar janë raportuar 30 raste të konfirmuara nga ana laboratorike me HBV nga të cilat, vetëm 7 (23.3%) raste kanë shfaqur shenja klinike të hepatitit. Rastet e tjera janë testuar për arsye të tjera siç është p.sh. depistimi. Të gjitha rastet janë hetuar dhe këshilluar për t’u ndjekur nga mjeku specialist. Incidenca e HBV është 0.3 raste/100 000 banorë në vend.

Grafiku 7. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara (%) sipas grup-moshave



Siç shihet nga grafiku 7, në muajin janar përqindjen më të lartë e ka grup-mosha 50-54 vjeç dhe 60-64 vjeç, përkatësisht me 29 % të rasteve.

Tabela 3. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara (%) sipas bashkive

Bashkia	Raste	%
Dibër	5	71.5
Lushnjë	2	28.5
Total	7	100


Bashkia Dibër ka edhe përqindjen më të lartë të rasteve të konfirmuara me 71.5 %.

Tabela 4. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara (%) sipas gjinisë

Gjinia	Raste	%
Femër	1	14.2
Mashkull	6	85.8
Total	7	100

Numri më i lartë i përket gjinisë mashkull me 85.8%

Grafiku 8. Numri i rasteve të reja të diagnostikuara me HBV




Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin janar janë raportuar 6 raste me HCV të cilat kanë rezultuar pozitiv pas testimit laboratorik. Vetëm 1 rast (16.6%) i moshës 49 vjeç, femër nga Durrësi është rast i konfirmuar sipas përkufizimit të rastit për HCV akut. Për rastin është kryer hetimi dhe është ndjekur nga mjekët specialistë. Incidenca e HCV në nivel kombëtar është 0.04 raste/100 000 banorë.

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS

Gjatë muajit janar 2024 janë kryer 29 ekzaminime për HIV (23 meshkuj dhe 6 femra) prej të cilave 6 raste (6 meshkuj) kanë rezultuar HIV pozitiv .

Grafiku 9 . Shpërndarja e testimeve dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë.



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitive është: Tiranë 5 raste, dhe 1 rast i huaj me nënshtetësi italiane. Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 5 raste i përket grup-moshës 25-34 vjeç dhe 1 rast i përket grup-moshës 35-44 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur 2 raste nga QSUT (Shërbimi Infektiv), 4 raste vijnë nga laboratorë/spitale privat (1- INTERMEDICA, 2 raste nga CAMBRIDGE dhe 1 rast nga spitali Vila Maria).

Gjatë muajit janar 2024 janë raportuar 6 raste të konfirmuar Sifiliz nga NJVKSH Tiranë.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit janar 2024 janë raportuar gjithsej 15 raste, nga të cilat: 13 raste me tuberkuloz (TB) pulmonar dhe 2 raste ekstrapulmonar. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 3 në Tiranë, 1 në Durrës, 1 në Lushnjë, 1 në Lezhë, 3 në Shkodër dhe 1 në Fier.

Rastet ekstrapulmonare janë kryesisht pleurite dhe versamente pleurale. Gjatë muajit janar 2024, 2 raste ekstrapulmonare janë përkatësisht: 1 në Peshkopi dhe 1 në Peqin. Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatrë bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 5: Shpërndarja e zoonozave në muajin janar 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecie).

	Janar(Raste 2024)	Incidenca (raste/100,000)2024
Antraks (Plasje)	0	0.0
Brucelozë	1	0.03
Leptospirozë	1	0.03
Rikecie	1	0.03


Për muajin janar është raportuar 1 rast i konfirmuar me Brucelozë nga NJVKSH Kukës, 1 rast i konfirmuar me Leptospirozë NJVKSH Tepelenë dhe 1 rast Rikecioze nga NJVKSH Elbasan.

7 Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19


Gjatë muajit janar 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 318 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin janar është 11.11 raste /100000 banorë.

Grafiku 10. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 65-74 vjeç me incidencë 26.07 raste për 100000 banorë e ndjekur nga grup-mosha 75+ vjeç me incidencë 24.08 raste për 100000 banorë.

Grafiku 11. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive




Bashkitë me incidencë më të lartë janë Himarë, Delvinë, Dropull etj.

Gjatë muajit janar 2024 janë raportuar 33 raste të shtruara në spital dhe tre raste vdekje.

7.2 Grip

Gjatë muajit janar janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 520 raste të konfirmuara me Grip, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin janar është 18.1 raste /100000 banorë. Grafiku 12 tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të viruseve qarkullues. Vërehet mbizoterim i Gripit Tipi A.



Grafiku 12. Tipi i viruseve qarkulluese

Në muajin janar qarkullimi i gripit arriti intensitet mesatar duke paraqitur aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën. Raste me grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.

8. Sëmundje të tjera

Malarie

Për muajin janar është raportuar 1 rast i konfirmuar në Laboratorin e Kontrollit të Vektorëve në ISHP me Malarie Plasmodium Falciparum. Rasti është i moshës 41 vjeç, gjinia mashkull banues në Berat.

DEKSI